REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 30.06.2025 Prot.39 (tridhjetëenëntë)

Protokoll nr. 39

I mbajtur sot më datë 30.06.2025, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 23.04.2025.
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin maj 2025";
5.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë";
6.P-V "Për miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i intresave të kredisë për strehim";
7.P-V "Për rishpërndarjen e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025";
8.P-V "Për miratimin e raportit të konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2024";
9.P-V "Për miratimin e programit buxhetor afat mesëm për vitet 2026-2028";
10. P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.128, datë 26.12.2024, *"Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në bashkinë Maliq, penalitetet dhe shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2025"*;
11. P-V"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.129, datë 26.12.2024, *"Për miratimin e numurit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera, për vitin 2025"*;
12. P-V"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.60, datë 30.05.2025, *"Për dhënien e mjeteve me huapërdorje, Agjensisë së Shërbimeve Mbështetëse"*;
13. "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.J.F dhe V.F banues në Fshatin.Strelcë Nj.A Gorë, banesat e të cilve u dogjën si shkak i rënies të zjarrit";
14.P-V "Për ngritjen e Bordit Artistik të Bashkisë Maliq";
15.P-V "Mbi miratimin e marrveshjes së bashkëpunimit, midis Bashkisë Maliq dhe Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë për hartimin e Planit Parauniversitar për Bashkinë Maliq";
16.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Ronaldo Skënderi; Marinathi Avrami; Xhuana Hoxhallari; Pranvera Begolli; Eriseld Jonusllari;Daniela Ibrahim; Dritan Çami; Petrit Kupe; Idlir Limllari; Gentiana Drabo; Rovena Terolli; Fevri Sherifi; Floreta Zaçe; Kristina Malelli; Aramando Dautllari; Almir Elezi; Andonaq Risto; Neresida Shindo; Dalina Krekas; Marjeta Xhelollari; Eglantina Balli;23 (njëzetëetre) këshilltarë

Mungesa: Enida Avdolli; Ilia Xhuti; Klea Baçi; Server Xhuti; Lulëzim Hoxhaj; Yllson Ibrahimllari; Faslli Zholi; Albina Xhejo 8 (tetë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti; Përgjegjës i Zyrës të Strehimit.z.Ledion Mullali, Përgjegjës i Sektorit Kulturë, Arte, Turizëm; z.Festim Tomorri

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithëve! Të nderuar kolegë Këshilltarë, i nderuar Kryetari i bashkisë, të nderuar pjesmarës, fillojmë këtë mbledhje të radhës të Këshillit Bashkiak, ashtu sikur jeni njoftuar, verifikojmë korumin, korumi realizohet sepse janë 23 Këshilltarë në sallë, mund të vijojmë me mbledhjen.Ju ftoj të miratojmë rendin e ditës, Kush është dakord?

Eglantina Balli: Kam për sa i përket rendit të ditës, ne si grup i opozitës kemi diçka për të deklaruar.Do më jepni lejë ta lexoj?

Ornildi Demollari: Po.

Eglantina Balli:Të nderuar Qytetarë,

Ne Këshilltarët e Këshillit Bashkiak Maliq, pas shumë përpjekjesh për të vendosur norma dhe regulla në punën tonë si përfaqësues të qytetarëve të Bashkisë Maliq, duke marrë më shumë përgjegjësi dhe seriozitet mandatin e dhënë nga qytetarët të cilët vendosën me votën e tyre që ne të jemi në opozitë, deklarojmë sot para jush dhe medias që ky mision fisnik dhe kushtetues është i pamundur të ushtrohet për një sërë arsyesh:

1. Maxhoranca e Këshillit nuk luan rolin e vet si vendimmarrëse , përfaqësuese dhe kontrolluese ,por është një zgjatim politik i vullnetit të Kryetarit të Bashkisë dhe për pasojë edhe Këshilli degjeneron në punën e tij si zgjatim i ekzekutivit.
2. Kemi kërkuar që të mblidhet Këshilli për tema që shqetësojnë dhe janë në interes të publikut që përfaqëson opozita dhe ata nuk përfshihen me muaj të tërë në axhendën e Këshillit duke respektuar nenin 53 të ligjit 139/2015 dhe nenin 61 të rregullores që i referohet që 1/3 e anëtarëve të Këshillit ka të drejtë të thërrasë një mbledhje jashtë radhe. Citoj:
"Në rastin kur thirrja e Mbledhjes kërkohet nga 1/3 anëtarëve të Këshillit, lajmërimi për thirrjen e Mbledhjes bëhet nga Sekretari brenda 15 ditëve kalendarike pas paraqitjes së

kërkesës nga 1/3 e anëtarëve të Këshillit, të paktën pesë (5) ditëpara datës së thirrjes së Mbledhjes. - Kjo nuk ndodh.

3. Mos marrjen e vendimit për zhvillimin e zgjedhjeve për kryesitë dhe kryetarët e fshatrave përkatësisht Zvezde dhe Drithas Poshtë (megjithëse komisioni i KB ka dhënë 3:2 konfirmimin) – Kjo bën që drejtuesit e Këshillit të shkelin Nenin 70 të ligjit 139/2015 Për vetëqeverisjen Vendore dhe rregulloren e Këshillit për zgjedhjet e strukturave komunitare të miratuar nga po ky Këshill.
4. Në mbledhjen jashtë radhe kemi kërkuar shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme për dëmet në frutikulturë , ende nuk kemi një raport vlerësimi të dëmit .....Ndodhur në këto kushte vendosim bojkotimin e mbledhjes dhe ju ftojmë dhe njëhere në reflektimin për zbatimin e ligjit dhe të rregullores.

Sa më sipër, dhe te tjera që nuk po i parashtrojmë pasi janë shkelje të përditshme ligjore e procedural që kanë sjellë situatën që Bashkia është në gjykim Penal e Civil për disa çështje, jep një panoramë të shëmtuar ku ndodhet KB Maliq si dhe drejtuesit e tij janë në statusin e shpërdorimit të detyrës.

Ne si këshilltarë kemi marrë vendim që të mos marim pjesë në Këshill derisa të vendoset ligji, rregulli dhe transparenca.

Pas 2 vitesh debatesh pa fund dhe pa rezutat,bojkoti i mbledhjeve ngel zgjidhja e vetme duke shpresuar në reflektimin e këshilltarëve të ndërgjegjshëm të Maxhoransës që do i kthejnë ligjshmërine këtij Këshilli.

Ju falenderojmë për vemendjen, takimet , bisedat dhe mbështetjen që na keni dhënë.ne do bojktojmë mbledhjen.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Të them diçka? Në fakt unë si Kryetar Bashkie, jam munduar të kem kontakt të rregullt me të dy grupet e Këshilltarve dhe nuk is hoh si të ndarë politikisht, megjithëatë është e drejta e tyre, ne do të vazhdojmë punën në shërbim të qyetarve.Shumë faleminderit!

Ornildi Demollari:Bëjmë 5 minuta pushim dhe kthehemi përsëri.

Ornildi Demollari: Atëherë. Vijojmë me mbledhjen. Ju lutem, se kemi filluar. Atëherë, pas një pesë minutësh pushim, vijojmë me mbledhjen e këshillit. Bëjmë një riverifikim të korumit. Korumi realizohet pasi janë gjashtëmbëdhjetë këshilltarë në sallë. Dhe konkretisht është:

Idlir Limllari, Zoti Idli Limllari, Zonja Rovena Terolli, Zoti Ronaldo Skënderi.Daniela Ibrahimi më fal, po drejtohem kështu.Mariana Avrami, Petrit Kope, Eriseldi Onusllari, Pranvera Begolli, Floret Azaçe, Armando.Dautllari, Xhoana Hoxhallari, Dritan Çami, Kristina Malelli, Fevri

Sherifi, Gentiana Drabo dhe unë Ornildi Demollari. Që do të thotë jemi gjashtëmbëdhjetë këshilltarë në sallë dhe realizohet korumi i mbledhjes.

Ornildi Demollari: u ftoj edhe një herë të miratojmë rendin e ditës.

Kush është dakord me rendin e ditës? 16 vota pro.

Kundër ka, nuk ka abstenim, nuk ka.

Miratohet rendi i ditës me 16 vota prao, faleminderit. Më lejoni t'ju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar, me projektvendimet e mbledhjes së kaluar, të cilat janë kthyer në vendime. Janë gjithsej shtatë vendime me karakter normativ dhe gjashtë me karakter kolektiv, të cilat janë kthyer në vendime tashmë.

Ornildi Demollari: Ju ftoj të miratojmë protokollin e mbledhjes së kaluar.
Kush është dakord me protokollin? 16 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Nuk ka abstenim, nuk ka.
Miratohet protokolli. Me 16 vota pro. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Më lejoni t'ju kujtoj edhe një herë konfliktin e interesit të nderuar kolegë, në qoftë se ndonjë nga ne këtu.Ka konflikt interesi me ndonjërën nga pikat e rendit të ditës.Është mirë që në atë pikë të mos përfshihet as në diskutime dhe as në votim.

Të faleminderit, vijojmë me.Pikën katër të rendit të ditës, projekt vendim mbi dhënien e ndihmës financiare nga Fondi gjashtë për qind për muajin maj dy mijë e njëzet e pesë.S'ka ndonjë koment këtu, komisioni përkatës e ka zhvilluar mbledhjen. Ka ndonjë pyetje?
E kalojmë votim, atëherë kush është dakord? 16 vota pro

Kundër? Nuk ka.
Nuk ka abstenim, nuk ka.
Miratohet protokolli. Me 16 vota pro. Faleminderit.
Ornildi Demollari: Kalojmë tek pika pesë e rendit të ditës, projekt vendim për dhënien e ndihmës financiare për familjet në nevojë, kush e do fjalën?Kryetar, ke diçka ku tek pika pesë?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Është një numër familjesh të mbartura prej muajsh, po duke qenë që është procesi zgjedhor, ne edhe ligjërisht e kemi patur të pamundur ta të të ndërhynim me këtë vendimarrje dhe nuk ia kemi sjellë këshillit bashkiak për të.marrë vendimin duhur, pasi duket si ndërhyrje apo si përdorim për efekte elektorale, kështu që tashmë që zgjedhjet kanë kaluar. të arsyeshme që bazuar në kompetencat që ka dhe këshilli i bashkisë ta sjellim këtë dhe relacioni shpjegues që ju kemi dhënë janë disa raste të cilat, edhe pse ndihmesa është minimale.të shpresojmë që ky vendimarrje e Këshillit të Bashkisë mund t'i ndihmojë në

sëmundje të ndryshme apo në diagnoza që Drejtoria e Ndihmës Ekonomike i ka parashtruar në relacionin që ju e keni bashkëngjitur prej vendimit.

Ornildi Demollari: Faleminderit, faleminderit, zoti kryetar, faleminderit. Kemi gjë?
E kalojmë votim atëherë?
Kush është dakord? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, miratohet pika pesë.Faleminderit. Shkojmë tek project-vendimi me numër gjashtë. Projekt vendim për miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i interesave të kredisë për strehimin.Kemi ndonjë pyetje këtu?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po, është vetëm një rast, me sa di unë për këtë projket-vendim.le të jetë ky një apel për të gjithë ata që duan të përfitojnë nga. subvencionet e interesave të kredisë për strehim janë fonde që mbulohen nga buxheti i shtetit.Ne jemi të gatshëm t'I ndihmojmë. Ndoshta këshilltarët vetë, qytetarët vetë, duhet ta shikojnë atë çfarë duhet të plotësojnë, që të kenë mundësi që ky moment të jetë shumë i rëndësishëm për përmirësimin e strehimit në të gjithë territorin e bashkisë Maliq.

Ornildi Demollari: Faleminderit, kemi gjë këtu e kalojmë votim.
Atëherë, Kush është dakord? 16 vota pro.
Kundë? Nuk ka
Abstenim, Nuk ka. Miratohet pika gjashtë.Faleminderit.

Ornildi Demollari:Të kalojmë tek pika shtatë e rendit të ditës, projektvendim për rishpërndarjen e buxhetit të bashkisë Maliq për vitin dy mijë e njëzet e pesë. Kemi një shpërndarje, komisioni i financës po.

Petrit Kupe: Duke filluar nga pika shtatë deri në pikën dymbëdhjetë, komisioni i shqyrtoi dhe ra dakord që të miratoja këto projek- vendime të paraqitura. Pika shtatë bën fjalë për pakësim dhe ndryshim, ndryshim nga buxheti i bashkisë dhe njësia, nuk ka ndonjë efekt financiar, ajo që është interesante është pika tetë, sepse miratohet raporti i konsoliduar i veprimtarisë së bashkisë në vitin 2024. Disa tregues thelbësorë që tregojnë mbi stabilitetin dhe ecurinë janë pozitiv krahasuar edhe me vitin 2023.Ajo që vihet re, që është edhe mangësi e zakonshme, por që ka tendencë drejt rritjes, është rritje të ardhura në krahasim me 2023, në 2024, nga pesëdhjetë për qind në pesëdhjetë e shtatë për qind. Edhe shpenzimet realizohen normalisht treguesi mjaft i kënaqshëm në masën 93% të vitit 2024, ajo diferencë është për shkak të vonesës së faturave. Kështu që ky raport jemi dakord të miratohet.

Ornildi Demollari: Kryetar, ke diçka?

Petrit Kupe: Pika nëntë, ja do t'i mbaroj të gjitha unë edhe pastaj pika nëntë, është një miratim formal i programit, i cili paraqitet pranë Ministrisë së Financëve për parashikimin në vitet e

ardhshme, në pikën dhjetë ka një ndryshim të taksave të taksës e ndikimit në infrastrukturë.sipas disa lloje objekteve, ku është parashikuar që të jenë nivele jo më të larta se maksimalja, por nivele mesatare.Nivele të hardhura në përqindje kundrejt preventivit, të cilat ndikojnë në rritjen e të harruar të buxhetit të bashkisë. Edhe për këtë, jemi dakord, në pikën njëmbëdhjetë ka disa ndryshime, jo në strukturë, por në disa vende pune që janë të domosdoshme. Për palestrën në pirg për sektorin e shërbimeve të tjera dhe për një veteriner të mesëm, meqë ra dhe kjo sëmundje tani, duhet ta kishim caktuar vetëm emrin s'ka aty, se përcaktuar çdo gjë dhe në pikën dymbëdhjetë, çshtë një thjesht një kalim i mjeteve kryesore nga, kanë patur qejf ta të bashkisnin mbanin në dorë, po e dukej që më mirë të jenë atje nga njësia.Kalojnë nga këtej në përdorim të njësisë, e cila mbulon nëntëdhjetë përqind të aktivitetit

Ornildi Demollari:Të agjensisë?

Petrit Kupe: Po të agjensisë, e cila mbulon dhe të mendoj unë mbi nëntëdhjetë për qind të shërbimeve që bëhen në bashki dhe janë të domosdoshme për veprimtarinë e tyre Këto kishin edhe si komision. Faleminderit, me gjerë kryetari e pastaj.

Ornildi Demollari: Kreytar!

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk kemi të bëjmë me shtesë fondesh, por kjo, kur ndryshojmë në kohë për programet buxhetore, ndryshon edhe një shtesë.

Ornildi Demollari: Faleminderit, e kalojmë votim pikën shtatë? Mbledhjes I bashkohet dhe Këshilltari Plator Çollaku, shkon në 17 numri i Këshilltrave në sallë.
E kalojmë votim atëherë?
Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, miratohet pika shtatë.Faleminderit. Kalojmë tek pika tetë e rendit të ditës, projekt vendim për miratimin. e raportit të konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin dy mijë e njëzet e pesë, dy mijë e njëzet e katër.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po siç e përmendi edhe Petriti në emër të Komisionit të Financës, është një raport pozitiv i gjithë veprimtarisë financiare të bashkisë me ligj, patjetër që ka vend për punë më të mira, edhe kjo pika e cila duhet të kemi punë shumë ka të bëjë me mbledhjen e të ardhurave për të siguruar sa më shumë shërbime ndaj komunitetit. Kështu që në këtë drejtim, në qoftë se ka ndonjë pyetje nga nga këshilltarët, ne jemi gatshëm drejtoria e financës t'i kthejë përgjigje. Në qoftë se ka ndonjë moment teknik, por e rëndësishme është që realizimi i shpenzimeve në nivele të kënaqshme në afro njëqind për qind do të thotë që është bërë një punë voluminoze, punë e mirë në të gjitha ato çfarë këshilli i bashkisë ka miratuar një vit më parë.Po ka ndonjë koment rreth kësaj?

Ornildi Demollari:E kalojmë votim atëherë ?

Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, miratohet tetë .Faleminderit Kalojmë tek pika nëntë e rendit të ditës, projekt-vendim për miratimin e programit buxhetor afatmesëm për vitet dy mijë e njëzet e gjashtë, dy mijë e njëzet e tetë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Edhe kjo është një detyrim ligjor, duke marrë në konsideratë tavanet buxhetore që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, ne çojmë në disa momente edhe në Ministrinë e Financave.Miratimin e tyre, duke bërë vërejtjet e duhura pas miratimit që Ministria e Financave na kalon, i sjellim përsëri në Këshillin e Bashkisë, që ato të marrin formë juridike ligjore edhe pse është një miratim të themi në parim, i cili rishikohet vit pas viti në varësi të transfercës që çel buxheti i shtetit apo të ardhurat buxhetore që ne sigurojmë nga të ardhurat tona.Kështu që, bazuar në këto tarifa, po ta shikoni, ka një rritje nga viti dy mijë e njëzet e gjashtë, dy mijë e njëzet e shtatë, dy mijë e njëzet e tetë, në varësi të tavaneve butë. Transfertës së pakrushëzuar i çel buxheti i shtetit, edhe kurse ajo buxheti i pavarur ngelet pothuaj në të njëjta nivele, duke marrë në konsideratë që bëhen në momentin e hartimit të buxhetit vjetor që ne.

Ornildi Demollari: Faleminderit, zoti kryetar. Kemi ndonjë gjë tjetër?E kalojmë votim pikën nëntë?
Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, miratohet .Faleminderit. Shkojmë tek pika dhjetë e rendit të ditës. P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.128, datë 26.12.2024, *"Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në bashkinë Maliq, penalitetet dhe shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2025";* Kryetar kishe gjë këtu ?Se komisioni e dha mendimin.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Në lidhje me tarifat është bërë vetëm një rregullim, pasi për efekt të subjekteve private, të cilat punojnë në territorin e bashkisë, i është vendosur një tarifë fikse, sikur të punoj një ditë, sikur të punoj një vit dhe ndryshimi që kemi bërë është që në varësi të kohëzgjatjes që ka një investim në territorin e bashkisë dhe vlerës që ajo ka, atëherë edhe tarifimi të jetë në bazë të kësaj pune për të të jenë më realist e më ferë me të gjitha subjektet ekonomike, si brenda ashtu edhe jashtë territorit të bashkisë.

Ornildi Demollari: Faleminderit, kemi ndonjë gjë këtu? E kalojmë votim?
Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, miratohet.Faleminderit. Shkojmë tek pika njëmbëdhjetë e rendit të ditës, P-V"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.129, datë 26.12.2024, *"Për miratimin e numurit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera, për vitin 2025";*

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po, siç e përmend pak më lart, kemi bërë disa rregullime shtesa, kemi shtuar një nënpunës veteriner, si të domosdoshëm, po ajo për të cilën ne e kemi marrë këtë nismë ka të bëjnë çik me qentë endacakë që janë nëpër rrugë për të bërë një riorganizim dhe një mbledhje dhe një ndërhyrje tek këta për efekt të anës veterinare ta quajmë, përveç sëmundjeve të tjera ose nevojave që ka komuniteti i zonës, besojmë se do të ishte shumë e domosdoshme dhe nga konsultat që kemi parë në vende të ndryshme, na është thënë që është me rëndësi dhe ka efekte të menjëhershme. E morëm këtë nismë, nuk është ndonjë vlerë e konsiderueshme, ndaj dhe kemi shtuar këtë si pozicion. Kemi shtuar një pozicion me gjashtë orë në shkollën e pirgut për efekt të ndërtimit të një palestre të re. Kemi bërë disa ndryshime, shtohet një pozicion punëtor krahun mirëmbajtje në vreshtas dhe punëtor mirëmbajtje në, i kemi bërë një ndryshim pozicione nga roje fushë në punëtor mirëmbajtje, në zonën e njësisë administrative të Libonikut. Këto janë dyshimet që ne kemi propozuar për efekt të këtij project-vendimi.

Ornildi Demollari: Kemi ndonjë gjë, ndonjë pyetje? E kalojmë votim?

Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, miratohet.Faleminderit. Shkojmë tek pika dymbëdhjetë, P-V"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.60, datë 30.05.2025, *"Për dhënien e mjeteve me huapërdorje, Agjensisë së Shërbimeve Mbështetëse";*
Ornildi Demollari:Kemi miratuar një project-vendim në një mbledhje, dy mbledhje përpara për punën e mjeteve që do t'i kalojnë agjensisë, tani janë dhe disa mjete të tjera që s'i kishin kaluar dhe janë në këtë projekt vendim, besoj e keni pare? Ka ndonjë pyetje? Ka nevojë për një shpjegim? E e kalojmë votim atëherë?
Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, miratohet.Faleminderit. Shkojmë tek pika trembëdhjetë, "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.J.F dhe z.V.F banues në Fshatin.Strelcë Nj.A Gorë, banesat e të cilve u dogjën si shkak i rënies të zjarrit"; Për dy familjet me inicialet J.F dhe V.F banues në fshatin Strelc, njësi administrative Gorë, banesat e të cilëve u dogjën si shkak i rënies së zjarrit.

Ronaldo Skënderi: Po përshëndetje të gjithëve, po përshëndetje të gjithëve. Kemi një pikë të rëndësishme, e cila lidhet me një familje në fshatin Stres, ku si pasojë e rënies së zjarrit u shkatërrua gjithë ndërtesa. Aktualisht, kjo familje po jeton në një çadër në kushte krejtësisht të papërshtatshme, le të themi, për banuar. Prandaj është ngritur edhe kjo pikë, ku janë marrë masa konkrete nga ana e Bashkisë Maliq për t'iu ardhur në ndihmë sa më shpejt kësaj familje dhe shpresojmë që ta kalojmë këtë pikë. Faleminderit.

Ornildi Demollari Po, faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Është një zjarr i cili komisioni e ka evidentuar bashkë me shërbimin zjarrfikës, me të gjithë, sektorin e emergjencave civile janë bërë për llogaritjet e

duhura. Paraprakisht kemi ndihmuar nëpërmjet, rezervave të shtetit, si në Korçë, por dhe edhe në Tiranë, me çadra një produkte ushqimore, të dyja familjet në një kohë rekord, ky është pastaj detyrimi ligjor për t'i mbështetur me një fond 417 mijë dhe 961 mijë në varësi të dëmit, të orendive, të përllogaritjeve që ka bërë komisioni, ju në projekt vendimi kini bashkëngjitur dhe kërkoj miratim nga ana juaj për ta bërë efektiv, që ata të kenë mundësi për të ndërhyrë në këtë kod. Dhe shumë mirë që është kohë vere, që ata të kenë mundësi të ndërtojnë edhe të ta kalojnë këtë emergjencë.

Ornildi Demollari:Po, duke shpresuar që t'ju vijmë sado pak në ndihme, kalojmë votim atëherë? Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, miratohet.Faleminderit. Kalojmë tek pika katërmbëdhjetë e rendit të ditës, projekt vendim për ngritjen e bordit artistik të bashkisë Maliq.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po është një diçka e re, po e bëjmë për herë të parë në këtë formë. Ne duhet të ngrejmë një bord artistik, pranë të përbërë nga pesë anëtarë, anëtarët e bordit kanë mandat katër vjeçar. Nuk janë me pagesë, janë pjesë të strukturave tona, apo ndoshta në qoftë se edhe këshilli do të ketë anëtar, aty s'ka asnjë të keqe, në përputhje me parashikimin e legjislacionit për organet kolegjiale, bordi artistik miraton rregulloret e artistit të organizimit dhe funksionimit, si dhe miraton listën e aktiviteteve artistike dhe ia paraqet kryetarit të bashkisë çdo fillim viti për miratim. Kryetari i bashkisë miraton listën e emërore të anëtarëve të bordit artistik në zbatim të vendimit.Në zbatim të vendimit ngarkohet Sektori i Kulturës, pranë Agjencisë së Shërbimeve. I njohur me këtë dhe unë besoj që është një domosdoshmëri se do të kryejë një lëvizje apo një ndryshim në një në një punë ndonjëherë që kthehet dhe në rutinë të aktiviteteve që ne kryejmë çdo vit.Duam ta lëvizim këtë, këtë mënyrë që të mos jetë gjëra të, të njëjta, por të ketë një ndryshim dhe besoj që edhe kjo do t'i japë një, një, një zhvillim, edhe një input kësaj pune.

Ornildi Demollari:Po Faleminderit, kemi gjë?

Pranvera Begolli: Në këtë bord mund të ketë dhe qytetarë të qytetit të Maliqit në marrëdhënie me kulturën në Vite?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Në këtë bord mund të ketë, po patjetër mund të ketë, po është siç e thashë pak më lart, është pa pagesë.

Pranvera Begolli: E kuptoj, thjesht të japin mendimet.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Patjetër, në qoftë se kryetari i bashkisë do ta shikojë të arsyeshme që aty të ketë njerëz që vërtetë kanë të bëjnë me kulturën, mos bëjmë një listë me pesë veta. që s'kanë të bëjnë me kulturën, kjo është shumë pozitive dhe ne jemi të gatshëm të jenë ata vërtetë të japin mendime sa më të mira.

Pranvera Begolli: Faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kështu që në këtë kuadër, në këtë kuadër mund të bëni edhe propozime konkrete. S'ka asnjë gjë të keqe, që ky bord të jetë sa më, jo vetëm nga Maliqi, po nga gjithë territori i bashkisë, njerëz që janë marrë me kulturën, me artin dhe që e ndiejnë në çdo moment. Por një gjë është e vërtetë, kur mblidhet bordi, duhet të vijnë se pastaj nuk arrijmë t'i mbledhim dhe t'i krijojmë korumet e duhura.

Ornildi Demollari:E kalojmë votim, atëherë?
Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, miratohet.Faleminderit. Shkojmë tek pika pesëmbëdhjetë e rendit. P-V "Mbi miratimin e marrveshjes së bashkëpunimit, midis Bashkisë Maliq dhe Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë për hartimin e Planit Parauniversitar për Bashkinë Maliq";

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po mund të shpjegoj një moment, këshilli i ministrave, ministria, ministri i shtetit për decentralizimin për pushtetin lokal, këtë vit ka futur për herë të parë një moment, i cili ka të bëjë me bashkitë, të cilat do të marrin një grant ekstra në varësi të performancës së tyre.Midis tyre, një nga pikat është, ky plan, i cili kërkojmë planin parauniversitar për parashkollorin, i cili është një nga piketat që duhet ta plotësojmë, duke qenë që ishte një program, Jo shumë i futur në ujërat tona, atëherë kërkuam ndihmën e Shoqatës Bashkive të Shqipërisë dhe kemi lidhur këtë marrëveshje që ata të na ndihmojnë bashkë me strukturat tona, bashkë me zyrën rajonale të arsimit në Maliq, zyrën arsimore, që të bëjmë një plan, i cili të plotësojë një nga kushtet.Kushtet e tjera jemi duke i realizuar për të bërë të mundur që të përfitojmë një grant shtesë në buxhetin e bashkisë për efekt të buxhetit të përgjithshëm të saj nga fondet e buxhetit të shtetit.

Ornildi Demollari:Ka pyetje? E kalojmë votim?
Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, miratohet.Faleminderit.

Ornildi Demollari:Kemi dhe një projektvendim që na ka erdhur pak më mbrapa.Janë dy project-vendime. Na ka erdhur pak më mbrapa, është projektvendim për aktivitetin kulturor verë dhe portokalle. Besoj e keni marrë?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë ia shpjegova pak këshillit të bashkisë, edhe që në mbledhjen e parë, edhe jam duke diskutuar përsëri me anëtarët e këshillit të bashkisë, që edhe pse bashkia jonë normalisht.Kryen punë çdo ditë, shërbime çdo ditë, dhe ndonjëherë kemi harruar pjesën e jetës kulturore artistike krahasimisht me qytete të tjera apo bashki të tjera, ndoshta ka ardhur koha që edhe ne të jemi të krijojmë një fizionomi tonë, edhe me aktivitete kombëtare të cilat kanë të bëjnë, që jepen të gjithë Shqipërinë, pse mos e japim edhe ne, patjetër

që ato kërkojnë shpenzime, kërkojnë pagesa, edhe janë pagesa që kryen në të gjitha aktivitetet këtij lloji nga të gjitha bashkitë nëpër Shqipëri, ndaj dhe pamë të arsyeshme që në qoftë se vitin e kaluar realizuam një project për shfaqjen e filmave që kishin të bëjnë me Maliqin, me tharjen e kënetës, e tjera, dhe duam ta realizojmë edhe këtë vit. Atëherë po shtojmë edhe dy aktivitete të tjera, të cilat bordi, po për fakt konkret, sektori i kulturës i shpall në faqet e bashkisë dhe aty mund të hyjë, mund të hyjnë organizata të ndryshme mund të hyjnë në aktivitete të ndryshme, të cilat janë në rang kombëtar, dhe ata përzgjedhin pastaj me kë do të përfaqësohemi, këtë vit kanë sjellë këto dyja apo tre bashkë me atë atë Sinamania, të cilat përbëjnë tre aktivitete që e shtojnë listën e aktiviteteve që vetë sektori i kulturës do të bëjë në qytet është e hapur kështilli i bashkisë, unë mendoj le ta kemi dhe ne një apo tre aktivitete, dy të paktën dy aktivitete kombëtare, siç jepen për gjithë Shqipërinë.

Ornildi Demollari:Dy që i kemi sot në projekt vendim është verë dhe portokalle, dhe aktiviteti i dytë është festa e madhe e këngës dy mijë e njëzet e pesë, se nuk e përmenda.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Apo këngë moj që i thonë që duam ta bëjmë dhe ne.

Petrit Kupe: Jam pro këtyre aktiviteteve, po duket sikur janë shumë pranë njëra-tjetrës.ndoshta do shtrirë në kohë, sepse është vetëm korriku, pushime, është edhe gushti.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ka të drejtë, ndoshta kjo le të negociohet. Problemi është se ata bëjnë një program gjithë Shqipërinë dhe aty kanë gjetur hapësirën Megjithatë, të negociohet ndoshta ka drejtë Petriti, që mund të jetë një në korrik në gusht.

Ornildi Demollari:Nuk e di, po hajde këtu festim, të lutem që të dëgjohesh, fol me mikrofon që të dëgjojnë.

Përgjegjës i Sektorit Kulturë, Arte, Turizëm; z.Festim Tomorri: Tani, këto dy aktivitete janë aktivitete që do t'i japin gjallëri qytetit normalisht.Gjithë qyteti këto aktivitete i shikon nëpër televizione, ku ato shfaqen direkt nëpër qytete të tjera, ishte një iniciativë e mirë e kryetarit, po edhe në bashkëpunim me ne, për ta bërë këtë në përgjigje të pyetjes që thotë dhe ka të drejtë Petriti. Këto aktivitete janë afër ngjitur me njëra-tjetrën, kjo erdhi si rezultat i asaj angazhimit tonë të vonshëm, sepse po ta kishim bërë që në fillim të vitit, do t'i përcaktonim më mirë datat.Kjo ishte herë e parë që e bëmë, prandaj edhe datat janë afër, sepse këto kishin, këto hapësira kishin subjektet, të cilat do të jenë pjesë e aktiviteteve. Vitin tjetër shpresojmë që ne t'i bëjmë që në fillim. Jo, unë kam bërë negociatë, kam biseduar me të dy, dhe të dy kanë vetëm këto data të lira, një i bie nëntëmbëdhjetë korrik, një njëzet e katër korrik, pastaj njëzet e tetë, njëzet e nëntë, tridhjetë e një kemi Sinemania. Do më mbyllen brenda korrikut. Po në vitin tjetër, unë shpresoj që ne do të negociojmë që në fillim të vitit për të përcaktuar data larg njëra-tjetrës.

Ornildi Demollari:Kjo ishte ajo që desha të theksoja.

Përgjegjës i Sektorit Kulturë, Arte, Turizëm; z.Festim Tomorri: Faleminderit, edhe një gjë tjetë që aty janë, do jetë aktiviteti i gjerë do në dy-tre orësh nga dy këta, kurse aktiviteti i Sinemanisë do të jetë tre-ditor dhe do të jetë më i gjatë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk e di, nuk e di sa e mundur ishte që kjo e sinemasë të mos bëhet vetëm në Maliq, po të bëhesh edhe në dy vende të tjera, një natë në Maliq, po them një natë në Pojan, një natë në zonë që janë më të populluara. Shikojeni si moment, nuk e di, mund të ketë shpenzime ekstra.

Përgjegjës i Sektorit Kulturë, Arte, Turizëm; z.Festim Tomorri: Kjo ishte problemi i shpenzimeve ekstra, sepse këtë e ka aplikuar Erseka. E bën në Ersek, e bën edhe në Leskovik, po e bën tre ditë e tre ditë. Këto kisha faleminderit.

Ornildi Demollari:Faleminderit. E kalojmë votimin?
Ju lutem, kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, miratohet.Faleminderit.

Ornildi Demollari:Tani kemi një informacion që na vjen nga Drejtoria e Shërbimit Social. është një faqe, nuk e di, e keni marrë apo duhet që t'ia përcjellë në lidhje me këtë qëndrën e fëmijëve, është i miratueshëm një projektvendim në lidhje me bashkëfinancimin e projekteve të projektit të dorëshkrimit.Ai i ka ardhur këshillit të bashkisë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ne sapo jemi shpallur fitues për të rehabilituar edhe 39 godina të tjera në territorin e bashkisë për familjet në nevojë dhe kjo kërkon një bashkinancim të kësaj pune, do desha që këshilli ta miratonte në parim, se e kemi futur në buxhet. Po ta miratonte në parim. Është, është një miratim që ne miratojmë bashkëfinancimin e miratuar në letër nga Ministria, tashmë është shkresa dhe të biem dakord që mos vonohemi në kohë, që të fillojnë procedurat.

Ornildi Demollari:Po, patjetër, mund të na i sjellë, po të bjerë këshilli, dakord, patjetër, mund të na i sjellë, atëherë mund ta, mund ta votojmë në parim, ju lutem.

Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, miratohet.Faleminderit.

Ornildi Demollari:Ky është një informacion që vjen nga Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit dhe Shëndetësisë.Lenda dërgim informacioni mbi funksionin.E qendrës së fëmijëve Maliq, drejtuar Këshillit të Bashkisë Maliq, në mbështetje të ligjit numër 139, 2015. Për vetëqeverisjen vendore, ligji nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë datë njëzet e gjashtë i gjashti dy mijë e tetë për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe ligjit numër, qind e

njëzet e një dy mijë e gjashtëmbëdhjetë për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë dhe VKM-së, numër pesëqind e tetëmbëdhjetë, datë 4 nëntor 2018 për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar rezidencial, kriteret, procedurat. për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar. Bashkia Maliq në bashkëpunim me Dorkas Albania dhe Misioni Emanuel ka nisur, implementimin dhe realizimin e një sërë aktivitetesh në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit për projektin e përbashkët, ngritjen e qendrës ditore për fëmijë. Qendra për zhvillimin e fëmijëve në Maliq është ngritur në muajin qershor dy mijë e njëzet e katër si një ndërhyrje sociale për të mbështetur fëmijët në nevojë që përballen me sfidat e natyrës ekonomike, arsimore dhe sociale. Ajo synon të ofrojë një mjedis të sigurt, edukues dhe gjithëpërfshirës për fëmijët përmes një modeli bashkëpunimi institucional dhe mbështetje komunitare. Dorkas Albania dhe Misioni Emanuela angazhohen në sigurimin e gjithë bazës materiale për zhvillimin e aktivitetit, duke përfshirë. Edhe pagesën e stafit përbërës së qendrës kuzhinierit dhe mësues për një periudhë trevjeçare me të drejtë rinovimi.Nga ana e Bashkisë Maliq mbulohet pagesa e qerasë së ambientit dhe faturat e energjisë elektrike ujit, si dhe një sanitare ndihmëse, ndërsa Këshilli i Qarkut të Korçë siguron kuotën ushqimore ditore për fëmijët që ndjekin qendrën, aktualisht qendra ofron shërbime për 20 fëmijë të klasave të para deri në klasë të shtatë, përzgjedhur nga terreni në bashkëpunim me shkollën dhe strukturat sociale, prej tyre katërmbëdhjetë vajza dhe gjashtë djem.Aktiviteti i qendrës. çdo ditë fëmijë, çdo fëmijë më falni përfiton një vakt të ngrohtë dhe ushqyes për përmirësuesi i shëndetit dhe përqëndrimit, dy fëmijët mbështeten nga mësuesjapër të përvetësuar më mirë mësimet dhe për të rritur rezultate në shkollë, tre edukim mbi emocionet, komunikimin, punën në grup dhe njohuritë bazë për jetën e shëndetshme në koordinim me shkollën dhe psikologët për vlerësimin e nevojave individuale të fëmijëve dhe ndërtimin e ndërhyrjeve specifike. Ky model ndër institucional bashkëpunimi ka dhënë efekte të dukshme pozitive, si për fëmijët përfitues, ashtu dhe për komunitetin në përgjithësi, Këshilli Bashkiak inkurajohet të mbështesëdhe të konsiderojë vijimësinë dhe zgjerimin e modelit në zona të tjera të Bashkisë Maliq në varësi të burimeve dhe mundësive. Ky ishte informacioni.

Ornildi Demollari:Faleminderit, tani shkojmë tek diskutime të ndryshme në qoftë se kemi ndonjë gjë.

Petrit Kupe: Po, tani ky informacioni dakord, po çfarë kërkon nga ana e bashkisë?

Ornildi Demollari:Jo, është, e kanë në proces, e kanë procedurat.

Petrit Kupe: Jo, në qoftë se, në qoftë se do fonde për atë që kërkon ajo nga ana e bashkisë, bëhen pro e vendimeve.

Ornildi Demollari: Jo, nuk thotë, është për fonde ajo, është dërgimi informacioni thotë.Po, Plator

Plator Çollaku: Bashkia Maliq ka qenë në marrëveshje me këtë organizatë më përpara?

Ornildi Demollari:: Me dorkas? Kemi një pyetje Kryetar?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mbajnë me ushqim, pregatisin mësimet, ata kanë pësuar një mësuese që u bënë mësim. Dhe na është shtuar numri i kërkesave të fëmijëve që duan të shkojnë në ajo qendër.Ne paguajmë vetëm qiranë e ambientit, gjithë të tjerat i paguan vetë Dorkasi dhe ata e menaxhojnë si qendër, ne jemi vetëm në suport me qiranë e saj. Unë e kam parë këtë eksperiencë në dy qendra që janë në qytetin e Korçës,më janë dukur shumë interesante.Viti i parë që po e zbatojmë ky që po ikën dhe besoj se ka qenë një njeri si një gjë positive, do ishim të hapur që edhe organizata të tjera, po të ketë, do ishim në mbështetje të tyre, kështu që Plator e ketë hapur rrugën

Ornildi Demollari: Faleminderit, kemi gjë tek diskutime të tjera?Atëherë, kjo ishte mbledhja për sot.Shumë faleminderit, mbledhja e këshillit.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ